

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-180/15

Prishtinë,  
7 dhjetor 2017

Në çështjen juridike të:

**R. H.**

*Pala ankuese*

kundër.

**A. M.**

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) KPCC/D/R/253/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA39148), të datës 28 gusht 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 7 dhjetor 2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e H. R. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/253/2014, të datës 25 gusht 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin 39148.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/253/2014, i datës 25 gusht 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA39148.

### Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 26 shtator 2007, A. M. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë M. M, ku kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore mbi banesën që gjendet në rrugën **“Nemanjina” nr. 8/5 (ish Mosa Pijada nr. 8), hyrja nr. 1, kati i II-të, banesa nr. 5,** Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Për të mbështetur kërkesën e saj pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar në AKP provat vijuese:
  - Faturën e datës 23 mars 1994 që dëshmon se M. M. ka paguar tërë çmimin blerës të banesës në shumën prej 51.235.18 Dinarësh (valutë serbe) në përputhje me Vendimin nr. 50/98,
  - Certifikatën e martesës nr. 202.537-94-05 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Leskocv më 8 gusht 1994, që dëshmon lidhjen në mes të palës përgjegjëse në ankesë dhe M. M.
  - Vërtetimin nr. 304 të lëshuar nga YU GARANT BANKA a.d. më 13 prill 1999 që vërteton se M.M. ka paguar çmimin blerës të banesës në shumën prej 51.235.18 Dinarësh (valutë serbe) në përputhje me vendimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës nr. 50/98, të datës 31 gusht 1998,
  - Vendimin nr. 50/98 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 31 gusht 1998, me të cilin gjykata konsideron se M. M. ka përmbushur të gjitha obligimet e tij në raport me pronën e kërkuar, gjë që i mundësohet atij për ta blerë të njëjtën. Vendimi ishte bërë i plotfuqishëm më 12 shkurt 1999,
  - Miratimin me shkrim nr. 1-84/98, të lëshuar nga Posti Ushtarak në Nish, ku i jepet autorizimi M. M. për tu regjistruar si pronar i ri i pronës së kërkuar,

- Vendimin Trashëgimor nr. 586/99 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Leskovcit më 22 korrik 2008, përmes së cilit, prona e kërkuar ishte trashëguar nga pala përgjegjëse në ankesë dhe dy fëmijët e saj, secili me 1/3 pjesë ideale të pronës,
3. Më 1 tetor 2008 Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë njoftimin e kërkesës duke e gjetur pronën e kërkuar të uzurpuar nga R. H. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) i cili pretendoi se e kishte blerë banesën nga pronari i saj legjitim.
  4. Për të mbështetur pretendimin e tij pala ankuese kishte dorëzuar provat vijuese:
    - Kontratën e shitblerjes të legalizuar pranë Gjykatës së Dytë Komunale të Beogradit me numrin e referencës nr. 906/99 më 19 janar 1999. Kontrata ishte lidhur në mes të M. M. në cilësinë e shitësit dhe Ž. J. në cilësinë e blerësit. Subjekt i shitblerjes ishte banesa që gjendet në **Rrugën “Nemanjina nr. 10/6” (ish rruga Mosa Pijada 8/6),**
    - Kontratën e shitblerjes të legalizuar pranë Gjykatës së Dytë Komunale të Beogradit nr. 907/99 më 21 janar 1999. Kontrata ishte lidhur në mes të Ž. J. në cilësinë e shitësit dhe M. M. në cilësinë e blerësit. Subjekt i shitblerjes ishte **rruga “Nemanjina nr. 10/6” (ish rruga Mosa Pijada 8/6),**
    - Kontratën e shitblerjes të legalizuar pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës me numrin nr. 1216/2000 më 20 korrik 2000. Kontrata ishte lidhur në mes të M.R. në cilësinë e shitësit dhe Q. H. në cilësinë e blerësit. Subjekti i shitblerjes ishte **rruga “Nemanjina nr. 10/6” (ish rruga Mosa Pijada 8/6),**
    - Kontratën mbi Dhuratën nr. 647/2010 të legalizuar pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës më 1 shkurt 2010. Kontrata ishte lidhur në mes të Q. H. në cilësinë e dhuruesit të dhuratës dhe R. H. në cilësinë e pranuesit të dhuratës. Subjekti i shitblerjes ishte **rruga “Nemanjina nr. 10/6” (ish rruga Mosa Pijada 8/6), hyrja nr. 8, banesa nr. 6,**
  5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i kishte verifikuar pozitivisht dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë.
  6. Më 25 gusht 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/R/253/2014 (paragrafët 28-30) vendosi se pala përgjegjëse në ankesë e kishte dëshmuar të drejtën pronësore të M.M. mbi pronën e kërkuar. Për sa i përket palës ankuese (paragrafi 29 i Vendimit) thekson si në vijim: pala përgjegjëse në kërkesë (pala ankuese në fazën aktuale) pretendon të drejtën ligjore ndaj pronës së kërkuar duke theksuar se babai i tij e kishte blerë banesën e kërkuar nga një palë e tretë dhe se ai më vonë kishte fituar të drejtën pronësore mbi pronën bazuar në Kontratën mbi Dhuratën. Ai kishte dorëzuar Kontratën e Blerjes dhe Kontratën mbi Dhuratën, megjithatë, kontratat nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar.

7. Më 21 janar 2015 Vendimi i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë.
8. Pala ankuese e kishte pranuar vendimin më 1 dhjetor 2014. Ankesa ishte paraqitur më 17 dhjetor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe asaj procedurale dhe gjithashtu vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
10. Pala ankuese thekson se Komisioni vendosi të njeh të drejtën pronësore të palës përgjegjëse në ankesë ndaj pronës së kërkuar duke mos marrë aspak në konsideratë dokumentet e dorëzuara nga ai.
11. Sipas palës ankuese Vendimi i KKPK-së është i paqartë dhe kundërthënës në mes të vendimit dhe provave në shkresat e lëndës dhe se nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm për provat kryesore që e mbështesin Vendimin e kundërshtuar. Pala ankuese thekson se atij nuk i është dhënë mundësia të dorëzojë prova materiale dhe ky veprim ka ndikuar Vendimin e kundërshtuar. Pala ankuese ia ka shitur pronën e kërkuar shumë vite më parë Ž. J., pastaj Ž. J. ia kishte shitur pronën e kërkuar M. R. dhe në fund M. R. ia kishte shitur atë Q. H. (babait të palës ankuese).
12. Pala ankuese ka theksuar se Vendimi i KKPK-së ishte lëshuar bazuar në Vendimin e Pjesshëm Trashëgimor gjë që sipas tij është vendim i jashtëligjshëm.
13. Në fund të ankesës së tij, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të prish Vendimin e KKPK-së dhe të hedhë poshtë Kërkesën KPA39148 apo të kthejë rastin në shqyrtim në shkallë të parë.
14. Pala ankuese i ka bashkangjitur ankesës së tij dokumentet e njëjtë që ishin marrë në konsideratë nga Komisioni.
15. Gjithashtu, pala ankuese kishte paraqitur Autorizimin nr. 8151/2014, të datës 15 dhjetor 2014, i cili dëshmon se ai i kishte autorizuar avokatët N.Th. dhe Q. Z. për ta përfaqësuar atë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës, Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës.

### **Arsyetimi ligjor**

**Pranueshmëria e ankesës**

16. Gjykata Supreme shqyrtoi Vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se:
17. Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për Vendimin.

**Meritat e ankesës**

18. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të parashtresave në dosjen e lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme vëren se ankesa është e pabazuar.
19. Vendimi i KKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk ka mundur të gjejë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe asaj procedurale.
20. Për sa i përket pretendimit të palës ankuese se Vendimi i KKPK-së është jo i qartë, kundërtshënës në mes të Vendimit dhe provave në dosje të lëndës dhe se nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm për provat kryesore që mbështesin Vendimin e kundërshtuar, KKPK-ja ka lëshuar Vendimin e vërtetuar të datës 25 gusht 2014. Vendimi përmend paragrafët përkatës në Vendimin Grupor. Referencë e veçantë i ishte bërë paragrafëve 28-30 të Vendimit.
21. Prandaj Gjykata Supreme do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se përse KKPK-ja nuk ka juridiksion në këtë lëndë.
22. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë e tij/saj mbi pronën e paluajtshme private, por edhe që ai/ajo nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore ndaj pronës përkatëse për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
23. Në mbështetje të kërkesës së saj, pala përgjegjëse në ankesë kishte paraqitur: Faturën e datës 23 mars 1994 që dëshmon se bashkëshorti i saj ka paguar tërë çmimin blerës për pronën e kërkuar, Vërtetimin nr. 304 të lëshuar nga YU GARANT BANKA a.d. më 13 prill 1999 i cili vërteton se çmimi blerës i pronës së kërkuar ishte paguar në përputhje me Vendimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës nr. 50/98 të datës 31 gusht 1998, Vendimin nr. 50/98 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 31 gusht 1998, me anë të së cilit gjykata konsideron se M.M. ka përmbushur të gjithë obligimet e tij në raport me pronën e kërkuar, duke i mundur atij blerjen e së njëjtën dhe Miratimin me Shkrim nr. 1-84/98, me të cilin, Ushtria jep pëlqimin e saj

- që M.M. të regjistrohet si pronar i ri i pronës së kërkuar. Të gjitha këto dokumente ishin verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së. Dokumenti kryesor që dëshmon të drejtën e bashkëshortit të palës përgjegjëse në ankesë mbi pronën e kërkuar ishte Vendimi i plotfuqishëm nr. 50/98 i lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 31 gusht 1998.
24. Pretendimi i palës ankuese se dokumentet nuk ishin marrë në konsideratë nga Komisioni dhe se atij nuk i ishte ofruar aspak mundësia të dorëzoj prova materiale nuk qëndron.
  25. Nga provat në dosje të lëndës në mënyrë të qartë dëshmohet se pala ankuese kishte nënshkruar Njoftimin mbi Pjesëmarrjen se ai do të jetë palë në procedurën para AKP-së më 11 janar 2008. Zbulimi i dokumenteve në mes të palëve ishte bërë, pala ankuese kishte pranuar dokumentet e palës përgjegjëse në ankesë më 23 janar 2012 (faqe 168 të dosjes) ndërsa ai i kishte dorëzuar dokumentet e tij më 11 nëntor 2008 dhe 14 shkurt 2012 (faqe nr. 40-60 të dosjes së lëndës), megjithatë, dokumentet e dorëzuara nga ai nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar.
  26. Prona e kërkuar është një banesë që gjendet në Rrugën **“Nemanjina nr. 8/5 (ish rruga Mosa Pijada nr. 8), hyrja nr. 1, kati i II-të, banesa nr. 5**, Komuna e Prishtinës ndërsa dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese i referohen banesës që gjendet në Rrugën **“Nemanjina nr. 10/6” (ish rruga Mosa Pijada 8/6), hyrja nr. 8, banesa nr. 6**, Komuna e Prishtinës. Ky fakt ishte sqaruar shumë mirë në paragrafin 29 të Vendimit të KKKP-së, KPCC/D/R/253/2014.
  27. Për sa i takon Vendimit të Pjesshëm Trashëgimor nr. 586/99 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Leskovcit më 22 korrik 2008, gjykata vëren se ky dokument nuk është marrë në konsideratë nga AKP-ja.
  28. Ankesa e R. përsërit të njëjtat pretendime të cilat ai i kishte bërë pranë KKKP-së. Me ankesën e tij ai nuk kishte dorëzuar prova të reja.
  29. Gjykata Supreme konstaton se KKKP-ja ka marr një vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të plotë dhe të drejtë. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
  30. Në bazë të asaj që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
  31. Ky aktgjykim nuk ka asnjë paragjykim ndaj asnjë pale për të kërkuar të drejtën ndaj pronës pranë gjykatës kompetente në Kosovë.

### Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it**

**Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar**

**Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it**